

**MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME  
TË ORTAKEVE  
TË ALGRAFIKA SHPK**

Sot më datë 30.12.2019, mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të ALGRAFIKA SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): J91601504N, me seli në adresën: "Autostrada Tr – Dr, Km. 8, Kodër Kashar, Katund i Ri, Tiranë, Zona Kadastrale 2119, nr. Pasurie 164/50 ("Shoqëria").

Janë të pranishëm ortakët si më poshtë:

- **Ervis Aga**, shtetas shqiptar, lindur më 12.03.1989, në Durrës, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. BC2196445;
- **DOBI MANAGEMENT Shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L01605034R, përfaqësuar nga administratori Erjon Dobi.

Të gjithë ortakët e pranishëm në mbledhje qe përfaqësojnë 100% te kapitalit themeltar te Shoqërisë, unanimisht e pranojnë dhe e konsiderojnë mbledhjen si të thirrur rregullisht.


Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron Z. Ilir Dobi në cilësinë e kryetarit të mbledhjes, e cila do të kryejë edhe detyrat e sekretarit të mbledhjes dhe është përgjegjës për mbajtjen e këtij procesverballi.

Është vërejtur se:

- Pjesëmarrësit në mbledhje formojnë kuorumin e nevojshëm sipas dispozitave të akteve të brendshme të Shoqërisë.
- Pjesëmarrësit kanë rënë dakord për Rendin e Ditës si vijon:

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i shkaqeve dhe procedurat për anulimin e likuidimin e kuotës ne shoqërinë Algrafika Shpk dhe ndryshimi përkatës i statutit te shoqërisë Algrafika Shpk.
2. Anulimi i kuotës se z. Aga dhe konvertimi i saj ne hua ndaj shoqërisë Algrafika Shpk.
3. Ndryshimi i Statutit te shoqërisë Algrafika Shpk si rrjedhoje anulimit te kuotës dhe rrjedhimisht largimit te ortakut z. Aga.
4. Konvertimin e vlerës se kuotës te zotëruar nga ortakut Z. Aga ne detyrim ne forme huaje te cilën Shoqëria është e detyruar te ripaguaj ndaj Z. Aga.



Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me unanimitet, në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës,

**VENDOSI:**

Miratimin e shkaqeve dhe procedurave për anulimin dhe likuidimin e kuotës në shoqërinë Algrafika Shpk si me poshtë vijon:

*"Kuota anulohet vetëm në rast të largimit të ortakut.*

*Anulimi dhe likuidimi i saj behet me vendim të ortakeve të Shoqërisë sipas përcaktimeve të nenit 13.4 të statutit të Shoqërisë, përfshirë këtu dhe ortakun përkatës të cilit i anulohet kuota."*

Si rrjedhojë e këtij vendimi, neni 11.2 pika iii e Statutit të shoqërisë Algrafika Shpk ndryshohet si vijon:

**"...Neni 11**

**Ortaku i Vetëm**

11.2. Ortaku i Vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve të Shoqërisë për çështjet e mëposhtme:

*iii. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre. Në çdo rast kuota anulohet vetëm në rast të largimit të ortakut. Anulimi dhe likuidimi i saj behet me vendim të ortakeve të Shoqërisë sipas përcaktimeve të nenit 13.4 të statutit të Shoqërisë, vendim që përfshin dhe ortakun përkatës të cilit i anulohet kuota...;"*

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me unanimitet, në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës,



**VENDOSI:**

Miratimin e anulimit të kuotës së z. Aga dhe konvertimin e saj në hua ndaj shoqërisë Algrafika Shpk sipas kontratës përkatëse midis palëve z. Aga dhe shoqëria Algrafika Shpk. Kjo hua do të shtohet vlerës së huasë ekzistuese.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me unanimitet, në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës,

**VENDOSI:**

Miratimin e ndryshimit të Statutit të shoqërisë Algrafika Shpk si rrjedhojë anulimit të kuotës dhe rrjedhimisht largimit të ortakut z. Aga si vijon:

2

*Ornelo  
Nleshko*



### "Neni 3

#### Ortaku i vetëm

3.1. Shoqëria zotërohet nga ortaku i vetëm:

- **DOBI MANAGEMENT Shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L01605034R, zotëruese e **1 (një) kuote, me vlerë ALL 352.388.465,19 (treqind e e pesëdhjetë e dy milion e treqind e tetëdhjetë e tete mije e katerqind e gjashtëdhjetë e pese presje nëntëmbëdhjetë Lekë), që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.**

(në vijim referuar si "Ortaku i Vetëm").

[...]"

### "Neni 7

#### Kapitali


7.1. Kapitali i Shoqërisë është ALL 352.388.465,19 (treqind e pesëdhjetë e dy milion e treqind e tetëdhjetë e tete mije e katerqind e gjashtëdhjetë e pese presje nëntëmbëdhjetë Lekë), dhe konsiston në 1 (një) kuote e zotëruar nga ortaku i vetëm:

- **DOBI MANAGEMENT Shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L01605034R, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë ALL 352.388.465,19 (treqind e pesëdhjetë e dy milion e treqind e tetëdhjetë e tete mije e katerqind e gjashtëdhjetë e pese presje nëntëmbëdhjetë Lekë), që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

[...]"

**Statuti i përditësuar që pasqyron ndryshimet e nevojshme ligjore dhe të miratuara sipas këtij vendimi bashkëlidhet këtu si pjese përbërëse e vendimit.**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me unanimitet, në lidhje me pikën e katert të rendit të ditës,



#### VENDOSI:

Të miratojë konvertimin dhe njohjen e vlerës së kuotës të zotëruar nga ortaku Z. Aga me vlerë të barabartë me ALL 38.524.423,39 (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e katërqind e njëzet e tre presje tridhjetë e nëntë lekë) si detyrim në formë huaje të cilën Shoqëria është e detyruar të ripaguaj ndaj Z. Aga sipas kushteve të kontratës lidhur mes palëve datë 30.12.2019.

Të miratojë përmbajtjen e Kontratës së Huasë dhe të Marrëveshjes Siguruese mbi Kuotat e Pjesëmarrjes në shoqërinë Algrafika Shpk, bashkëlidhur këtij Vendimi, si dhe të autorizojë administratorin Z. Ilir Dobi për të nënshkruar ato në emër të Shoqërisë.

3

Duke mos pasur me çështje ne rend te ditës për te diskutuar, mbledhja deklarohet e mbyllur.

**Dobi Management**

**Erjon Dobi**  
Administrator

*Erjon Dobi*  
*[Signature]*



**Ervis Aga**

*Ervis Aga*  
*[Signature]*

*Arifetë Memu.*

*[Signature]*

*Ornelo Dileci*  
*[Signature]*

